



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Legjislatura III
Sesioni vjeshtor

Mbledhja plenare e Kuvendit
P- 127
Prishtinë, më 15 shtator 2010

PROCESVERBAL

**I MBLEDHJES PLENARE TË KUVENDIT TË REPUBLIKËS SË KOSOVËS, TË
MBAJTUR MË 15 SHTATOR 2010**

Mbledhjen e drejtoi **Jakup Krasniqi**, kryetar i Kuvendit, kurse i ndihmoi **Eqrem Kryeziu**, anëtar i Kryesisë së Kuvendit.

Kryetari konstatoi se në sallë janë të pranishëm 64 deputetë dhe i deklaroi të hapur punimet e mbledhjes.

Ai i njoftoi deputetët se Kryesia e Kuvendit, në marrëveshje me kryetarët e grupeve parlamentare, ka përgatitur dhe Kuvendit ia ka paraqitur rendin e ditës për mbledhjen e sotme plenare.

Në vazhdim, Kuvendi i zhvilloi punimet me këtë:

Rend dite

1. Koha për deklarime jashtë rendit të ditës,
2. Koha për pyetje parlamentare,
3. Debat parlamentar lidhur me procesin e privatizimit të PTK-së, sipas Mocionit të Grupit Parlamentar të LDD-së

1. Koha për deklarime jashtë rendit të ditës

Për deklarime jashtë rendit të ditës diskutuan këta deputetë: Zylfije Hundozi, Danush Ademi, Myzejene Selmani, Rexhep Hoti, Melihate Termkolli, Nait Hasani, Bujar Dugolli, Riza Smaka, Ismajl Kurteshi, Rita Hajzeraj dhe kryeministri Hashim Thaçi.

2. Koha për pyetje parlamentare

Deputeti **Driton Tali**, parashtoi pyetje për kryeministrin Hashim Thaçi, apo ministrin Ahmet Shala lidhur me investimet e Qeverisë në letrat me vlerë dhe me çfarë interesi janë bërë ato.

Ministri **Ahmet Shala** iu përgjigj pyetjes së deputetit Driton Tali.

Deputeti **Driton Tali**, parashtoi pyetje për kryeministrin Hashim Thaçi, apo ministrin Ahmet Shala lidhur me monitorimin e fushatës për krijimin e imazhit ndërkombëtar të vendit me titull "Kosovo the young europeans", tenderin e së cilës e pati fituar kompania izraelite "BBR Saatchi & Saatchi".

Ministri **Ahmet Shala** iu përgjigj pyetjes së deputetit Driton Tali.

Deputeti **Riza Smaka**, parashtoi pyetje për ministrin Ahmet Shala lidhur me parregullsitë e shumta të cilat janë të paraqitura në raportet e Auditorit të Përgjithshëm, referuar ndërmarrjeve publike në Kosovë dhe cilat masa do t'i ndërmerr ministria që ai drejton për eliminimin e këtyre parregullsive.

Ministri **Ahmet Shala** iu përgjigj pyetjes së deputetit Riza Smaka.

Deputeti **Riza Smaka**, parashtoi pyetje për ministrin Lutfi Haziri lidhur me mundësinë e miratimit të projektit për Eposin e këngëve epike shqiptare dhe promovimin e këtij projekti në korpusin tematik të trashëgimisë kulturore botërore.

Ministri **Lutfi Haziri** iu përgjigj pyetjes së deputetit Riza Smaka.

Deputetja **Myrvete Pantina**, parashtoi pyetje për ministrin Ahmet Shala lidhur me instalimin e arkave fiskale nga ana e operatorit të dytë "Dukagjini".

Ministri **Ahmet Shala** iu përgjigj pyetjes së deputetes Myrvete Pantina.

Deputetja **Drita Maliqi**, parashtoi pyetje për ministrin Enver Hoxhaj lidhur me hapjen e 20-30 fakulteteve me programe të njëjta, sidomos të shkencave ekonomike-juridike në Kosovë.

Ministri **Enver Hoxhaj** iu përgjigj pyetjes së deputetes Drita Maliqi.

Deputetja **Drita Maliqi**, parashtoi pyetje për ministrin Enver Hoxhaj lidhur me gjendjen e cilësisë së arsimit në vend.

Ministri **Enver Hoxhaj** iu përgjigj pyetjes së deputetes Drita Maliqi.

Deputeti **Naim Rrustemi**, parashtroi pyetje për ministren Justina Shiroka- Pula lidhur me vlerësimet e ministres për përfshirjen e termocentralit “Kosova B” në pakon tenderuese me termocentralin “Kosova e Re”.

Ministrja Justina Shiroka- Pula mungoi, pyetjes së deputetit Rrustemi nuk iu përgjigj askush.

3. Debat parlamentar lidhur me procesin e privatizimit të PTK-së, sipas mocionit të Grupit Parlamentar të LDD-së

Kryesuesi tha se Grupi Parlamentar i LDD-së ka kërkuar debat parlamentar për procesin e privatizimit të Postë-Telekomit të Kosovës.

Ai ftoi kryetarin ose përfaqësuesin e Grupit Parlamentar të LDD-së që në emër të grupit parlamentar të marrë fjalën.

Besa Gaxherri, në fillim tha se procesi i privatizimit është proces mjaft i rëndësishëm për ekonominë e një vendi, proces ky i cili kërkon transparencë më të madhe, legjislacion adekuat dhe profesionalizëm më të lartë, komponente këto të cilat po i mungojnë procesit të privatizimit të PTK-së. Si pasojë të kësaj situate, ajo e quajti procesin e privatizimit të dështuar.

Në vazhdim, tha se privatizimit të PTK-së do të duhej t’i paraprinte nxjerrja e një Ligji të veçantë për privatizimin e PTK-së, e të mës bëhet kjo përmes një dokumenti, siç është Strategjia për privatizimin e PTK-së. Ajo tha se PTK-ja ka vlerën mbi 1 miliard euro.

Deputetja Gaxherri më tej kritikoi Qeverinë e Kosovës edhe për angazhimin e kompanive konsulente për përgatitjen e mënyrës së privatizimit të PTK-së, duke dhënë mjete për këtë qëllim në vlerë prej 500.000 euro.

Kontributi i PTK-së për Qeverinë, për vitet 2009 – 2010, është 280 milionë euro, pa përfshirë këtu donacionet e shumta të PTK-së për strehim të familjeve, për shëndetësi, për arsim, kulturë, sport etj.

Ajo përmendi edhe disa dobësi të tjera të cilat paraqiten si pengesë në zhvillimin më të hovshëm të PTK-së, siç janë: automatizimi i sporteleve, renovimi i zyrave postale, mos hapja e Postë-Bankës, mos largimi i operatorëve ilegal etj.

Në fund, ajo konstatoi se për shkak të këtyre dobësive dhe të tjera, që kësaj radhe nuk u përmendën, në emër të Grupit Parlamentar të LDD-së kërkoi që kjo kompani sidomos në këtë fazë të mos privatizohet.

Kryetari ftoi më pas për fjalë ministrin e Ekonomisë dhe të Financave.

Ministri **Ahmet Shala**, në fillim tha se në emër të Grupit ndërminstoror për privatizimin e PTK-së dhe në emër të Qeverisë së Kosovës do ti paraqes argumentet pse Qeveria ka marrë vendim për privatizimin e pjesshëm të PTK-së. Privatizimi i ndërmarrjeve publike nga ana e Qeverisë së Kosovës është i bazuar në nenin 160 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, ndërsa neni. 9 i Ligjit të ndërmarrjeve publike përcakton se privatizimi duhet të bëhet me shitjen e aksioneve, duke përshkruar edhe procedurat konform këtij ligji. Prandaj, dilemat për ekzistimin apo jo të bazës ligjore për privatizimin edhe të PTK-së, duhet të hiqen, tha ai.

Arësyeshmërinë për privatizimin e PTK-së e kemi paraqitur edhe në Strategjinë e privatizimit të PTK-së, ndërkaq është për keqardhje që komisioni parlamentar funksional nuk ka arritur të sjellë rekomandime në bazë të kompetencave të cilat i takojnë.

Në vazhdim, ministri tha se trendi i probabilitetit të PTK-së, nga viti 2007 është më i vogël, kjo si pasojë e konkurrencës së gjithmbarshme. Nevojën e privatizimit ai e arsyetoi me faktin se nuk do të mund të zhvillohet asnjë sektor ekonomik pa konkurrencën e sektorit privat, sepse e njëjta gjë ka ndodhur edhe në vendet e rajonit.

Ai më tej përmendi si fat të privatizimit të PTK-së faktin se tani për tani në rajon operojnë 5-6 investitorë strategjikë dhe të fuqishëm evropian.

Respektimi me përpikëri i zbatimit të programit të FMN-së në transformimin e sektorit publik në atë privat, qoftë nga fusha energjetike apo të postë- telekomit janë një garanci për ecjen drejt plotësimit të programit për sigurimin e mjeteve financiare nga donacionet, konstatoi ministri.

Opinione, vërejtje dhe sugjerime lidhur me këtë pikë të rendit të ditës dhanë këta deputetë: në emër të grupit parlamentar të PDK-së, Sala Berisha-Shala, në emër të Grupit Parlamentar të LDK-së, Fatmir Rexhepi, në emër të Grupit Parlamentar të AAK-së, Ardian Gjini, në emër të Grupit Parlamentar të AKR-së, Myzejene Selmani, në emër të Grupit Parlamentar të LDD-së, Lulzim Zeneli, në emër të Grupit Parlamentar '7+', Xhezair Murati, ndërsa në emër të Grupit Parlamentar për Integrim, Vezira Emrush, si dhe deputetët: Driton Tali, Ramë Buja, Rexhep Hoti, Synavere Rysha, Naim Rustemi, Teuta Hadri, Berim Ramosaj, Besa Gaxherri, Naim Maloku, Ibrahim Makolli, Qamile Morina, Ismajl Kurteshi, Bahri Hyseni, Zef Morina, Ramadan Avdiu, Myrvete Pantina, Mark Krasniqi, kryeministri Hashim Thaçi, Gani Geci, Gani Buçinca, Riza Smaka, Mimoza Ahmetaj, Melihate Termkolli, Jakup Krasniqi, Naser Rugova, Emrush Xhemajli, Sanije Aliaj dhe ministri Ahmet Shala, që janë dhënë në transkript.

Lulzim Zeneli, në emër të Grupit Parlamentar të LDD-së, në fund të debatit tha se si është e mundur që Qeveria të hapë tenderin e privatizimit pa vendimin e Kuvendit, duke e konsideruar gjithashtu lajthitje për të gjithë partnerët ekonomikë, të cilët janë të interesuar të marrin pjesë me investime në Kosovë.

Ai, në fund, në emër të Grupit Parlamentar të LDD-së propozoi që Kuvendi i Kosovës të nxjerr një vendim përmes të cilit do të kërkonte nga Qeveria e Kosovës të ndërpres çdo aktivitet që lidhet me shitjen e PTK-së, deri sa nuk bëhet një vlerësim i detajuar i aseteve të PTK-së.

Kryetari **Jakup Krasniqi**, në fjalën përmbledhëse tha se Kuvendi ngarkon Komisionin për Ekonomi, Tregti, Industri, Energjetikë, Transport dhe Telekomunikacion që ta shqyrtojë Strategjinë e privatizimit të PTK-së dhe propozimin e ri të Qeverisë së Republikës së Kosovës për privatizimin e PTK-së, dhe gjatë dhjetë ditëve, në konsultim me ministrin dhe komisionin ndërministror, Kuvendit t'i paraqesin Raportin me rekomandime, të përgatitura mbi bazën e këshillave profesionale.

Kryesuesi e deklaroi të mbyllur mbledhjen në orën 17 : 00 minuta.

Kryetari i Kuvendit
Jakup KRASNIQI

Përgatiti: Divizioni për Çështje Plenare dhe Procedurale